generous financial support that the European Union and the EU Office in Kosovo have provided for the International Business College in Mitrovica (IBC-M). However, as this financing model comes to an end soon, we have agreed to work together so that the Government of Kosovo and the EU jointly consider the best modalities that would assure IBC-M's sustainability in the years to come.

Let me reiterate that I value the contribution that IBC-M brings forth in terms of providing collaborative spaces that foster inclusive education for all ethnic groups in Kosovo, especially in areas like South and North Mitrovica. Moreover, the institution's participation in European projects and partnerships has promoted Kosovo's academic work and helped internationalize the work of its teaching and scientific community. As such and as emphasized during the meeting, IBC-M is a higher education institution that is worth supporting. However, I also need to acknowledge the serious challenges that IBC-M's current business model brings as well as the necessity to review a number of available scenarios that would ensure its sustainability. Given IBC-M's legal status (it being registered as a Foundation), the options are rather limited in regards to the applicable legislation in Kosovo. Therefore, to move further on our joint efforts for IBC-M, I commit to the following:

a) Work together with you and the key stakeholders at the Government of Kosovo to review IBC-M's business model and explore modalities that would help IBC-M provide sustainability as a higher education institution from 2023 and onwards.
b) Set up a core Taskforce/Working Group that will explore possible outcomes and propose a joint solution for 2023. The Taskforce/Working Group will also include representatives of the Deputy – Prime Minister Bislimi's office, the EU Office, the Ministry of Finance, Labor and Transfers, and other key representatives deemed relevant for this goal, especially legal and financial experts with a specialized knowledge on the issue. A representative of the IBC-M itself may also be invited to join the Taskforce/Working Group either fully or on needs basis.

On the other hand, during the meeting, you have assured me that until a doable and collaborative solution has been found by the said Taskforce/Working Group, the EU Office will continue to financially support IBC-M throughout 2022 (i.e., by the end of December 2022) so that the institution and its students can rest assured that a final agreed-upon outcome for IBC-M is being worked on.

I remain hopeful that the joint commitment by MESTI, the Government of Kosovo and the EU Office in Kosovo will deliver a plausible and sustainable model for IBC-M in 2023.

Arbërie Nagavci

Minister of Education, Science, Technology, and Innovation

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Zyra e Kryeministrit – Kancelarija Predsednika Vlade – Office of the Prime Minister

Mr. Tomáš Szunyog
EU Special Representative (EUSR)
EU Office in Kosovo/EU Special Representative in Kosovo

Ref. no: 100 /2022
July 19, 2022

Subject: Re: Future funding of the International Business College in Mitrovica (IBC-M)

Dear Mr. Szunyog,

Following your recent letter (13/07/2022) regarding the future funding of International Business College in Mitrovica (IBC-M) I am replying to reconfirm the Government of Kosovo (GoK) commitment to find a sustainable solution for the IBC-M.

As you are aware, GoK has established a Task Force, chaired by MESTI, to explore options for sustainability of IBC-M as a higher education institution. Over the period of two months the Task Force has been working with high intensity, has met five times including a visit to both campuses in Mitrovica, in order to find a long term financial solution. In its 4th meeting (of 07/07/2022) and based on an analysis by the competent department at Ministry of Finance, Labor and Transfers the Task Force has discussed thoroughly one of the possible options i.e. Public Private Partnership (PPP). Unfortunately, this option which in first instance looked feasible for the Task Force, has resulted impossible within the current legislative framework in Kosovo. However, ruling out PPP should not discourage us all and we shall continue to explore other options.

Finding a final solution for the future sustainability of the IBC-M is very complex and there are limited options. Therefore, we are grateful that your office has secured the funds and initiated the procedures to establish the new grant of a duration of next eight months (until 28/02/2023). Thus, we would like to reassure you that we remain firmly committed to cover the running costs for the remaining months of academic year 2022/23. I trust that this would enable you to proceed with 8-month grant contract with IBC-M and allow the Task Force to continue exploring other finance options.

Meanwhile, we are aware of the difficult financial situation in the IBC-M as well as challenges in retaining its current academic staff. In this regard, MESTI has taken a decision last week (15/07/2022) and extended the College's license for the period 01/10/2022 until 31/12/2024 (Decision No 5-1672) which has been submitted to IBC-M.

We remain hopeful that the joint commitment will deliver a plausible and sustainable financial solution for IBC-M for the period beyond 2023.

Should you require any further information we remain available.

Best regards,

Besnik Bislimi

First Deputy Prime Minister in charge of European Integration, Development and Dialogue
Republic of Kosovo

Cc. Ms. Arbërie Nagavci
Minister of Education, Science, Technology and Innovation

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
Zyra e Kryeministrit – Kancelarija Predsednika Vlade – Office of the Prime Minister

Mr. Tomáš Szunyog
EU Special Representative (EUSR)
EU Office in Kosovo/EU Special Representative in Kosovo

Ref. no: 052/2022
May 12, 2022

**Subject:** **International Business College in Mitrovica (IBC-M)**

Dear Mr. Szunyog,

I am writing in regards to our continued efforts to find a sustainable solution for International Business College in Mitrovica (IBC-M).

We remain committed to find a sustainable financial solution for IBC-M. These commitments have been listed in the letter of MEST addressed to you on 24 March, 2022. Since then we have established a Task Force/Working group that will work together with you and key stakeholders, including IBC-M, to review their business model and explore modalities that would help IBC-M to provide sustainability as a higher education institution.

Until then, we appreciate your readiness to cover the running costs for academic year 2022/23 during 2022 and we shall be doing so for the costs during first part of 2023.

We remain hopeful that the joint commitment will deliver a plausible and sustainable financial solution for IBC-M for the period beyond 2023.

Should you require any further information we remain available.

Best regards,

Besnik Bislimi

First Deputy Prime Minister in charge of European Integration, Development and Dialogue
Republic of Kosovo

**Koncept dokumenti për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe financimit të kolegjit IBCM në Mitrovicë.**

Në bazë të përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara me vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Nr. 01B-126, Datë: 18.05.2022 për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e modalitetit të qëndrueshmërisë dhe mbështetjes financiare për IBCM nga viti 2023 dhe në vijim, Grupi Punues (GP) pas 3 muaj punë intenzive dhe një numër takimesh të mbajtura, duke përfshirë edhe takime me menaxhmentin dhe bordin udhëheqës të IBCM, vizitës në dy kampuset e IBCM në Mitrovicë, takimeve me stafin akademik, jo-akademik dhe studentë të kolegjit IBCM, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të shqyrtuar, propozimeve dhe analizave për opsione të financimit dhe qëndrueshmërisë për IBCM, i rekomandon Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit znj. Arbërie Nagavci, Zëvendës Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës z. Besnik Bislimi opsionin për shndërrimin e kolegjit IBCM në institucion publik të arsimit të lartë me statutin "**Kolegj**".

GP në takimet e rregullta (12 takime) të mbajtura, ka shqyrtuar një numër opsionesh, skenarësh për modalitetet e sigurimit të financimit dhe qëndrueshmërisë së IBCM, opsione dhe skenarë të cilat po ashtu kanë qenë të paraqitura në shkresat e IBCM dërguar MASHTI-t dhe Qeverisë së Kosovës.

Opsionet e konsideruara kanë përfshirë:

a) Opsioni për mundësinë e një partneriteti publiko-privat;
b) Opsioni për kolegj privat (duke ruajtur statusin e vet si fondacion) me financim nga MASHTI;
c) Bashkimi i IBCM me një universitet/kolegj tjetër, si dhe
d) Shndërrimi i IBCM në institucion publik të arsimit të lartë.

Nga shqyrtimi i opsioneve të lartpërmendura dhe duke marrë për bazë legjislacionin përkatës në fuqi ( Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Ligjin për Partneritet Publiko-Privat) si dhe konsultimet dhe analizat nga departamenti i PPP në MFPT, konsultimeve të brendshme të GP, konsultimet me palë tjera dhe njohës të legjislacionit të arsimit në Kosovë, GP konsideron se nga opsionet e lartpërmendura, si opsioni më i realizueshëm dhe i cili ka bazë të mjaftueshme ligjore, mbetet opsioni e shndërrimit të IBCM në Institucion Publik të Arsimit të Lartë me statut "**Kolegj**" (bazuar në Ligjin për AL në Kosovë).

## 1. Transformimi i IBCM në institucion publik (Kolegj)

Mbështetur në dispozitat e ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Neni 6, 8 9, 11 dhe 17), MASHTI përveç themelimit të Universiteteve mund të themeloj edhe institucione tjera të Arsimit të Lartë, sikurse "Kolegji ".[1] Udhëzimi Administrativ i MASHTI-t, Nr. 01/2013, datë 16.01.2013 për Emërtimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë[2], në Nenin 2 përcakton emërtimet e IAL-ve në Kosovë, përfshirë emërtimin Kolegj.

---

[1] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.14, 9 Shtator 2011.
[2] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Udhëzimi Administrativ i MASHTI-t, Nr. 01/2013, datë 16.01.2013

**1.1.Kolegji?**

Bazuar në fushë veprimtarinë e IBCM, programeve dhe vizionit të saj për të ardhmen, GP konsideron se statuti "Kolegj" është më i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të institucionit në të ardhmen.

Shndërrimi i IBCM në kolegj lidhet ngushtë me misionin dhe veprimtarinë e institucionit dhe po ashtu përshtatet shumë mirë në sistemin e ofruesve publik të arsimit të lartë në Kosovë, kjo do të ofroj një shumëllojshmëri të sistemit të arsimit të lartë duke sjell risi në sistemin e arsimit të lartë publik në vend.

Nevojës dhe rëndësisë për themelimin e një institucioni të ri publik të arsimit të lartë në Kosovë, duke e transferuar Kolegjin IBCM aktual, i paraprijnë një sërë aspektesh të rëndësishme:

- Së pari, si një prioritet shtetëror, ka qenë vendim i Qeverisë së Kosovës (2008) që të themelojë një Kolegj Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM) në Mitrovicë, me qëllim që të ofrojë arsim të lartë profesional cilësor të përballueshëm për grupet e integruara të studentëve me prejardhje të ndryshme etnike në atë që atë kohë shihej si çështje problematike, jo vetëm në atë zonë. Shndërrimi në Kolegj do të mundësonte integrimin e institucionit në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë dhe krijonte bazën për qëndrueshmëri afatgjatë financiare të mbështetur nga buxheti i Republikës së Kosovës.

- Së dyti, sfidat në veri (dhe pjesë tjera) të Kosovës akoma nuk janë zbehur që atëherë, por Kolegji ka arritur të luajë një rol unik në ofrimin e arsimit cilësor përmes grupeve të integruara të studentëve me prejardhje të ndryshme kombëtare dhe etnike. Investimi paraprak i Qeverisë së Kosovës në vitin 2008, dhe i donatorëve të ndryshëm në vazhdimësi, sikurse SIDA, DANIDA, dhe pastaj BE, etj, rezultoi në ndërtimin e kampuseve të reja me infrastrukturë të mirëfilltë, dhe në ofrimin më të gjerë të programeve në nivelet e kualifikimit të 5-të dhe të nivelit Bachelor, dhe ndërkohë edhe në nivelin Master, qe tani ka dhënë rezultate të prekshme. Praktika e tillë pozitive dhe e suksesshme e ofrimit të arsimit cilësor, me studentin në qendër, ofrim të diplomave të dyfishta, mësimdhënie në gjuhën angleze, si dhe bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë, e bën që ky institucion të jetë unik në radhët e institucioneve tjera publike, dhe kështu premton potencial të mirëfilltë në shndërrim në një qendre të ekselencës, studimeve, dijes dhe inovacionit në një të ardhme të afërt.

- Më tutje, mbështetja për shndërrimin dhe financimin e IBCM në një Kolegj publik nga Qeveria e Kosovës tani është më se e domosdoshme, pasi institucioni ka fituar njohjen ndërkombëtare dhe ka një rrjet të partneritetit të gjerë të bashkëpunimit në Evropë dhe më gjerë, njëkohësisht edhe duke u akredituar nga një agjenci gjermane të sigurimit të cilësisë (EVALAG[3]), dhe pastaj duke marrë validim të Akreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKK), si dhe duke dhënë diploma të dyfishta së bashku me një institucion danez (Universiteti i Shkencave të Aplikuara Lillebaelt[4]) dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara nga Lituania[5].

- Parimi dhe misioni kryesor që ky institucion do bartë, si institucion arsimor publik në Kosovë që ofron arsim të integruar dhe klasa të përziera etnike (përfshirë edhe studentët nga komuniteti serb), është: "Ofrimi i një edukimi cilësor në gjuhën angleze për

---

[3] https://www.evalag.de/en/agency

[4] https://www.ucl.dk/international

[5] https://en.viko.lt/

studentët nga të gjitha komunitetet në tërë vendin dhe në rajon, i cili ndihmon në përmirësimin e perspektivave të drejtpërdrejta ekonomike dhe integrimin socio-ekonomik të gjitha komuniteteve". Ky Kolegj pra shndërrohet në një model të shkëlqyeshëm të reformës arsimore për institucionet e tjera të arsimit të lartë në Kosovë, i cili integron plotësisht të gjitha komunitetet në arsim, gjë që synohet dukshëm edhe me (draft) Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026.

- Ky potencial që ka institucioni është i rëndësishëm edhe në mbështetjen e institucioneve tjera publike në Kosovë duke ndihmuar ato në zhvillimin e tyre në ndërtimin e kapaciteteve akademike dhe hulumtuese. IBCM ka dëshmuar të jetë institucion lider i ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Kosovë përmes udhëheqjes së shumë projekteve për ngritje të kapacitetve , sikurse: T2P[6], ResearchCult[7], STAND[8], etj. Projektet janë strukturore dhe kanë në partneritet të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

- Projekti Ngritja e kulturës kërkimore në arsimin e lartë në Kosovë (ResearchCult) tanimë ka dhënë kontribute edhe tek IAL tjera publike në Kosovë duke ju dhënë qasje në librarinë online Ebsco dhe në sistemin antiplagjiaturë Plagiarism Check, ku mbi 1500 llogari të librarisë online (EBSCO) dhe 1500 llogari të sistemit antiplagjiat (Plagiarism Check) janë shpërndarë tek 7 universitetet publike në Kosovë.

- Njëkohësisht, kolegji IBCM ka dëshmuar të jetë një partner i ngushtë edhe i Qeverisë së Kosovës, duke kontribuar në shumë sfera në avancimin dhe realizimin e kornizës ligjore dhe strategjike, me theks në fushën e arsimit, kërkimit dhe inovacionit, por edhe në sektorë tjerë.

- Tutje, kolegji do jetë po ashtu në shërbim në të ardhmen në ngritjen e kapaciteteve të administratës publike në vend dhe më gjerë, përmes bashkëpunimit të mëtutjeshëm me Qeverinë e Kosovës (nivelin qendror dhe lokal) dhe duke sjellë bashkëpunime të reja me partnerë aktual dhe të rinj ndërkombëtarë. IBCM/kolegji në kuadër të fakultetit të shkencave sociale ofron edhe drejtimin e administratës publike dhe mirëqenies me dy specializime, në menaxhimin e shërbimeve publike dhe punës sociale. Kësisoj, ka disa vite që IBCM ka lidhur bashkëpunim me disa komuna ku secilës komunë i ofrohen deri në tri bursa, qoftë për të deleguar stafin e tyre për studime në IBCM apo për të përzgjedhur studentë nga komunat e tyre.

### 1.2. Specifikat e modelit të Institucionit Publik "Kolegjit"

Me qëllim të ruajtjes së neutralitetit dhe ndjeshmërisë së komuniteteve jo shumicë, GP konsideron se një statut më i veçantë i qeverisjes dhe funksionimit do të duhej të përcaktohej për institucionin/Kolegjin.

- Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë, shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues emërohet nga institucioni, ndërsa pjesën tjetër e emëron MASHTI, gjithsesi me qëllim të ruajtjes së neutralitetit dhe ndjeshmërisë së komuniteteve jo shumicë, një

[6] www.t2p-centers.com
[7] www.researchcult.net
[8] www.stand-project.org

Këshill Drejtues (KD) që siguron përbërjen shumë etnike dhe ndërkombëtare të kolegjit do të duhej të kihej parasysh.

- Kolegji do të ruante modalitetet e veta të programeve dhe misionin e vet të funksionimit mbi bazën e programeve të trashëguara, dhe formës së organizimit të tyre nga Kolegji aktual IBCM.
- Kolegji do të vazhdonte të ofronte programe në gjuhën angleze dhe me mundësinë e diplomave të dyfishta apo të përbashkëta.
- Përveç organeve drejtuese të përcaktuara në bazë të ligjit për arsimin e lartë në Kosovë, me qëllim të ruajtjes së neutralitetit dhe ndjeshmërisë së komuniteteve jo shumicë në Kosovë, kolegji do të krijoj edhe Bordin Industrial i përbërë nga përfaqësues të bizneseve duke përfshirë përfaqësues të bizneseve nga komunitetet e ndryshme në Kosovë.

### 1.3.Financimi i Kolegjit

Financimi i bartësve publik të AL në Kosovë është i rregulluar me ligjin për arsimin e lartë në Kosovë (Neni 20, 21 dhe 22).

- Marrë parasysh specifikat e Kolegjit – IBCM të ofrimit të programeve ndërkombëtare, diplomave të dyfishta, personalit akademik, administratës, konviktet për banimin e studentëve nga qytetet tjera, mensës së studentëve, kostove të mirëmbajtjes së infrastrukturës në dy kampuse, si dhe investimeve kapitale të nevojshme dhe kostove për mallra dhe shërbimeve, do duhet të konsiderohet një financim me një buxhet që mbulon këto kosto dhe që mundëson zhvillim dhe avancim të Kolegjit është i domosdoshëm.
- Qeveria e Kosovës duke futur Kolegjin në Buxhetin e Republikës së Kosovës - siguron financimin e Kolegjit, duke lejuar me ligj ndarje buxhetore për shpenzim nga Buxheti i Kosovë qe mbulon të gjitha shpenzimet e kolegjit dhe i mundëson kolegjit të ofroj regjistrim të studentëve me tarifa të studimit të njëjta me tarifat që ofrohen në institucionet tjera publike të AL në Kosovë. Përveç kësaj ligji për ndarjen buxhetore mund të lejoj që Kolegji të mund të përcaktojë vet tarifat e studimeve për studentët ndërkombëtarë.
- Kostoja e parashikuar financiare vjetore për Kolegjin për vitet e para të financimit është rreth 1 deri në 1.3 milion EURO për tri vitet e para, me mundësi të rritjes së buxhetit sipas rritjes dhe zgjerimit që mund të ketë kolegji në të ardhmen, konform planit të biznesit dhe marrëveshjes me Qeverinë e Kosovës. Një buxhet të ndarë në linja buxhetore, mund ta gjeni si **Aneks 1** të këtij dokumenti.

### 1.4.Struktura organizative e Kolegjit

Funksionimi dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet në statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi (Ligji për arsimin e lartë, Neni 17, paragrafi 1). Gjithashtu për të qenë në harmoni me emërtimet në projekt-ligjin e ri të pagave i cili pritet të miratohet në të ardhmen, konsiderojmë se emërtimet sipas ligjit janë më të përshtatshme dhe nuk krijojnë konfuzitet ligjor.

Si është sqaruar më sipër, Kolegji në strukturën e vet qeverisëse përbëhet nga:

- Këshilli Drejtues
- Këshilli Akademik
- Rektori

Kolegji formon Bordin Industrial me funksion këshillëdhënës për Këshillin Drejtues, Rektorin dhe njësitë akademike, në zhvillim e adaptim të programeve studimore dhe ndërlidhjen me tregun e punës.

Bordi Industrial është trupë profesionale joformale këshillëdhënëse për Kolegjin, qëllim i tij i vetëm është këshillimi për orientimin strategjinë të kolegjit si dhe të ndihmesës së ndërlidhjes së kualifikimeve me tregun e punës.
Bordi Industrial organizohet në baza vullnetare dhe anëtaret e tij nuk kompensohen për angazhimin e tyre.




**Rektori** – është përfaqësuesi ligjor dhe zyrtari ekzekutiv i institucionit. Punën e Rektorit e mbështesin tre prorektorët si në vijim:

- Prorektori për Çështje Akademike dhe Cilësi;
- Prorektori për Bashkëpunim & Kërkim Shkencor;
- Prorektori për Financa, Infrastrukturë & Administratë.

Prorektorët janë përgjegjës për të ndihmuar punën e rektorit si dhe zbatimin e angazhimeve të deleguar nga rektori apo të përcaktuara me statut të Kolegjit.
Prorektorët angazhohen në punën e tyre në nivel të menaxhmentit të lartë të kolegjit, ata janë staf i rregullt akademik dhe zgjedhja e tyre rregullohet me statut të kolegjit.

Zyra e Rektorit ka edhe staf tjetër mbështetës, Asistentin e zyrës.

**Këshilli Akademik** – përbëhet nga përfaqësues të fakulteteve, dhe përfaqësues të studentëve.

**Fakulteti** – Fakulteti kryesohet nga udhëheqësi /Dekani. Punën e fakultetit e mbështesin stafi akademik, varësisht sipas programeve studimore që funksionojnë në fakultet.
Një organizim i kolegjit me një fakultet, nuk i përgjigjet vizionit për zhvillim të kolegjit, andaj konsiderojmë se kolegji duhet të jetë i organizuar në fakultete.
Aktualisht, sipas numrit të fushave ekzistuese të studimeve, Kolegji i ka 4 fakultete:

- Fakuteti i Menaxhmentit & Shitjes Ndërkombëtare;
- Fakuteti i Menaxhimit të Mjedisit dhe Bujqësisë;
- Fakuteti i Shkencave Sociale;
- Fakuteti i Shkencave Kompjuterike;

**Sekretari** – është udhëheqësi dhe përgjegjësi për administratën, menaxhon me burimet njerëzore, dhe mbulon çështjet juridike të institucionit. Sekretari mbështetet edhe nga një zyrtar tjetër në zyrën e vet në realizim të mandatit dhe punëve që i delegohen.

**Zyra për Cilësi & Zhvillim Akademik** – përbëhet nga një zyrtar për sigurim të cilësisë, dhe një zyrtar për zhvillim të çështjeve akademike e didaktike.

**Zyra për Bashkëpunim, Projekte & Kërkim shkencor** – përbëhet nga një zyrtar për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe kërkim shkencor, dhe një zyrtar për projekte dhe bashkëpunim me biznese.

**Zyra për Financa & Administratë** – përbëhet nga drejtori për buxhet dhe financa, një zyrtar për shpenzim dhe certifikim, dhe një zyrtar për prokurim si dhe menaxheri i personelit.

**Zyra për Marrëdhënie me Publikun & Marketing** – përbëhet së paku nga një zyrtar për marrëdhënie me publikun, që e mbështetë direkt edhe Zyrën e Rektorit (etj), dhe një zyrtar për marketing.

**Shërbimi studentor & karrierës** – përbëhet nga së paku tre zyrtarë për çështje studentore, njëri nga të cilët ngarkohet edhe me çështjet e këshillimit në karrierë.

**Zyra e IT** – ka së paku një zyrtar për IT.

**Logjistika & Mirëmbajtja teknike** – përbëhet së paku nga një zyrtar përgjegjës për logjistikë dhe transport, një zyrtar për mirëmbajtje teknike të objekteve të institucionit, dhe katër staf teknik për mirëmbajtje higjenike të institucionit.

Numrin total si dhe strukturën e detajuar të stafit akademik dhe administrativ e gjeni në **Aneks 2** të këtij dokumenti.

2. **Hapat e ardhshëm dhe plani i zbatimit për themelimin e "Kolegjit" dhe bartjen e aseteve të IBCM tek Kolegji.**

Grupi Punues pas analizimit dhe shqyrtimit të detajuar për transformimin e IBCM në institucion publik (Kolegj) si dhe pas përgatitjes së koncept dokumentit dhe pranimit të komenteve nga gjithë anëtarët e GP, Kabineti i Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, zyrës së BE në Kosovë si dhe konsultimit me njohës të fushës së arsimit të lartë dhe ligjeve në Kosovë, ka finalizuar koncept dokumentin për transformimin e IBCM në institucion publik (Kolegjit) dhe i dorëzon këtë dokument Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Nagavci, dhe Zëvendës Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, z. Bislimi.

Pas aprovimit të koncept dokumentit nga znj. Nagavci dhe z. Bislimi, hapat e mëtutjeshëm të propozuar dhe të nevojshëm janë:

- MASHTI nxjerr vendim për themelimin e Kolegjit si institucion publik i arsimit të lartë, konform Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi. Vendimi më pas dërgohet në Qeveri për aprovim dhe për tu proceduar më pas për ratifikim në Kuvendin e Kosovës. Vendimi mund të përmbajë edhe këtë ecuri të punës siç sqarohet në këtë koncept dokument dhe siç dakordohet me Qeverinë e Kosovës. Realizimi i kësaj pike të kryhet gjatë muajit **shkurt 2023.**

Hapat në vazhdim përfshijnë:

1. MASHTI formon Këshillin Iniciues për themelimin e IAL (kolegjit)
2. Këshilli Iniciues përgatitë elaboratin për themelimin e IAL (kolegjit). themelim.

2.1. Këshilli Iniciues harton statutin e përkohshëm të IAL (kolegjit)
2.2. Këshilli Iniciues planifikon koston financiare/buxhetin për IAL (kolegjin).

3. IAL i bënë kërkesë MASHTI-it për themelim.
4. MASHTI nxjerr vendim për themelim dhe përmes Qeverisë vendimi dërgohet në Kuvendin e Kosovës për aprovim.
5. Kuvendi merr vendim për themelimin e IAL (kolegjit)

Pasi të kalohen këta hapa, në bazë të statutit fillon punën IAL në krijimin/zgjedhjen e organeve të institucionit sipas legjislacionit në fuqi, si:

- Organizimi i zgjedhje të studentëve,
- Organizimi i zgjedhje të stafit akademik (Këshillat të Fakulteteve, Senatorëve, Dekanëve).
- Zgjedhja e Rektorit,
- Këshilli Drejtues i IAL (kolegjit).

Me zgjedhjen e këtyre organeve të IAL (kolegjit) në bazë të statutit Këshilli Iniciues përfundon mandatin.

- Qeveria e Kosovës aprovon vendimin për themelimin e kolegjit dhe e procedon atë për ratifikim në kuvendin e Kosovës **(prill 2023)**

- Kuvendi i Kosovës ratifikon vendimin për themelimin e kolegjit **prill-maj 2023)**

- Qeveria e Kosovës e planifikon në Buxhetin e Kosovës për 2023 buxhetin e Kolegjit për 2023 dhe po ashtu përfshinë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) buxhetin e Kolegjit edhe për vitet tjera, sipas procedurës së rregullt. Realizimi i kësaj pike të kryhet gjatë muajit **(Maj 2023)**

- Pas ratifikimit të vendimit në Kuvend, themelohen organet e përkohshme qeverisëse të Kolegjit: Këshilli Drejtues, Rektori me prorektorë, dhe Këshilli akademik. Kjo të realizohet gjatë muajve **(Qershor – Gusht 2023)**

- MASHTI dhe Kolegji IBCM nënshkruajnë një Memorandum Bashkëpunimi (MoU) duke përcaktuar hapat tutje për modalitetet e transferimit të struktures, programeve studimore, dhe asetetve ekzistuese të IBCM tek institucioni publik i themeluar. MoU po ashtu përmban buxhetin për tri vite për Kolegjin, duke specifikuar nevojat e institucionit për zhvillim të mëtutjeshëm gjatë kësaj periudhe kohore **(Qershor - dhjetor 2023).**
- Bordi i IBCM nënshkruan një MoU me Rektorin e kolegjit për transferimin dhe pranimin e të gjitha aseteve (financiare, materiale, etj.) të IBCM tek Kolegji. Kjo të realizohet gjatë muajit **Qershor 2023.**

- Procedura për bartjen e aseteve të IBCM tek kolegji do të bëhet duke marrë për bazë dy modalitete si në vijim:
    3. Bartja e aseteve nga IBCM tek Kolegji do të bëhet pas një analize ligjore për bartjen e aseteve duke analizuar Ligjin për asociim, statutin e IBCM, MoU në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Sida (Swidish International Development Cooperation Agency) dhe Spark të nënshkruar në tetor 2010 si dhe dokumenteve tjera të IBCM. Qeveria e Kosovës/MASHTI fton në një takim përfaqësues të SIDA dhe ambasadës së Suedisë për të diskutuar dhe marrë aprovimin e donatoreve për transferimin e aseteve të IBCM tek kolegji.

    4. IBCM dhe Kolegji nënshkruajnë një MoU për bartjen/faljen ose shfrytëzimin pa kushte dhe pa kosto të aseteve pa patur nevojë që IBCM të mbyllet. IBCM ndërron statusin e vet nga Fondacion në Institut (lejuar me ligjin për asociim) dhe shërben si institut për kërkim shkencor dhe inovacion brenda kolegjit.

e) Strukturat e emëruara të Kolegjit (Këshilli Drejtues, Rektori dhe ekipi i vet, Këshilli Akademik, etj), gjatë periudhës **maj - korrik 2023**, zhvillojnë dhe transformojnë strukturat adekuate të Kolegjit sipas konceptit të dakorduar në MoU mes Qeverisë dhe IBCM, duke adoptuar Statutin (e përkohshëm), dhe rregulloret relevante për operacionalizimin e punës së institucionit.

f) Në fillim të vitit akademik 2023/24 **(tetor 2023),** Kolegji vazhdon punën e vet si strukturë e kompletuar për këtë fazë të zhvillimit.

Grupi Punues
Prishtinë, 12.02.2023

**Aneks 1. Buxheti i Kolegjit 2023-2025**

| Organizata buxhetore IBCM | Viti 2023 Korrik-Dhjetor Vlerësimi | Viti 2024 Vlerësimi | Viti 2025 Vlerësimi |
|---|---|---|---|
| Numri i punëtorëve | 55 | 60 | 60-66 |
| Paga dhe shtesa | 350,000 | 765,000 | 820,000 |
| Mallra dhe shërbime | 30,000 | 80,000 | 90,000 |
| Shpenzime komunale | 20,000 | 50,000 | 50,000 |
| Subvencione dhe Transfere | 20,000 | 65,000 | 65,000 |
| Shpenzime kapitale | 200,000 | 150,000 | 100,000 |
| **Totali** | **620,000** | **1,110,000** | **1,125,000** |

**Aneks 2. Stafi akademik dhe administrativ i Kolegjit 2023 -2025**

| Njësia | Kategoria e stafit | Menaxh. | Akad. | Admin. |
|---|---|---|---|---|
| **Rektorati** | Rektori | 1 | | |
| | Prorektoret | 3 | | |
| | Asistent ne Zyrën e Rektorit | | | 1 |
| **Fakulteti i Menaxhmentit & Shitjes Ndërkombëtare** | Dekani | 1 | | |
| | Profesorë ne programin aktual Bachelor | | 3 | |
| | Profesorë ne programin aktual Master | | 2 | |
| | Profesorë ne program te ri | | 3 | |
| | Staf akademik - asistente (staf i ri) | | 3 | |
| **Fakulteti i Menaxhimit të Mjedisit dhe Bujqësisë** | Dekani | 1 | | |
| | Profesorë ne programin aktual Bachelor | | 3 | |
| | Profesorë ne program te ri | | 3 | |
| | Staf akademik - asistente (staf i ri) | | 2 | |
| **Fakulteti i Shkencave Sociale** | Dekani | 1 | | |
| | Profesorë ne programin aktual Bachelor | | 3 | |
| | Profesorë ne program te ri | | 3 | |
| | Staf akademik - asistente (staf i ri) | | 2 | |
| **Fakulteti i Shkencave Kompjuterike** | Dekani | 1 | | |
| | Profesorë ne programin aktual Bachelor | | 3 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Profesorë ne program te ri | | 3 | |
| | Staf akademik - asistente (staf i ri) | | 2 | |
| **Zyra e Sekretarit** | Sekretari | 1 | | |
| **Zyra për Cilësi & Zhvillim Akademik** | Zyrtar për Sigurim te Cilësisë | | | 1 |
| **Zyra për Bashkëpunim, Projekte & Kërkim shkencor** | Zyrtar për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe kërkim shkencor | | | 1 |
| | Zyrtar për realizim te projekteve te mobilitetit | | | 1 |
| | Zyrtar për projekte dhe bashkëpunim me biznese | | | 1 |
| **Zyra për Financa & Administratë** | Zyrtar për buxhet dhe financa | | | 1 |
| | Zyrtar për shpenzim dhe certifikim | | | 1 |
| | Zyrtar për prokurim | | | 1 |
| **Zyra për Marrëdhënie me Publikun & Marketing** | Zyrtar për marrëdhënie me publiku | | | 1 |
| | Zyrtar për marketing | | | 2 |
| **Shërbimi studentor & karrierës** | Zyrtar për çështje studentore & karrierës | | | 1 |
| | Zyrtar për çështje studentore | | | 2 |
| **Zyra për IT** | Zyrtar për IT & zhvillim dhe mirëmbajtje te webfaqes | | | 1 |
| **Logjistika & Mirëmbajtja teknike** | Zyrtar për logjistikë dhe transport | | | 1 |
| | Zyrtar për mirëmbajtje teknike të objekteve të institucionit | | | 2 |
| | Staf teknik për mirëmbajtje higjienike të institucionit | | | 4 |
| ***Total Stafi për kategori*** | | **9** | **35** | **22** |
| **TOTAL stafi** | **66** | | | |

IBC-M International Business College Mitrovica
www.ibcmitrovica.eu | info@ibcmitrovica.eu
+383 (0) 28 534 834 | +381 (0) 28 409 013

**Për:** Arbërie NAGAVCI
Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë
dhe Inovacionit/ Qeveria e Republikës së Kosovës

International Business College Mitrovica
**Date:** 21 / 07 / 2023
**Protocol no.:** 321/07/23

21 korrik 2023

**Lënda:** ***Kërkesë për alokimin e mjeteve sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/152, Datë: 14.07.2023 për periudhën (01 mars 2023 – 30 qershor 2023) si dhe periudhën korrik 2023 dhe në vijim***

E nderuara Ministre e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit

Në vazhdim të letrës paraprake mbi kërkesën për sqarim mbi shfrytëzimin e mjeteve për kolegjin IBC-M sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/152, Datë: 14.07.2023 për periudhën (01 mars 2023 – 30 qershor 2023) si dhe periudhën korrik 2023 dhe në vijim, për të cilën kërkesë jemi duke pritur përgjigje po dergojmë kërkesën zyrtare për buxhetin e paraparë sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/152, Datë: 14.07.2023 si dhe letërzotimit të zv.kryeministrit Z.Bislimi së bashku me buxhetin e detajuar me linja buxhetore të njëjta sipas grantit nga BE dhe sipas dakordimeve paraprake nëpërmes letërzotimeve nga Qeveria e Kosovës.

Bazuar në letërzotimet e Qeverisë së Kosovës nga Zëvendëskryeministri z.Besnik Bislimi (Ref. No. 052/2022, Dt. 12 maj 2022, Ref. No. 100/2022, Dt. 19 Korrik 2022) është dakorduar që Qeveria e Kosovës do të marr përsipër të gjitha shpenzimet sa i përket funksionimit të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM) nga 1 marsi i vitit 2023 me kosto të njëjtë buxhetore sikurse të grantit të BE-së. Bazuar në dakordimet paraprake në mes të Qeverisë të Kosovës dhe zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, IBC-M ka vazhduar të operoj duke mbuluar kostot financiare nga granti i BE, si dhe duke përdorur mjetet e projekteve të financuar nga fondet tjera për periudhën Mars-Qershor 2023 me qëllim që mos të krijoj zbrazësi financiare në mbulimin e pagave dhe të shpenzimeve tjera operative, duke u konsultuar edhe me zv.kryeministrin Bislimi. Kësisoj, IBC-M ka huazuar mjete nga projektet e tjera të cilat kanë qenë të dedikuara për shpenzime tjera sipas aktiviteteve të projektit dhe të cilat duhet të kthehen në kontot buxhetore të projekteve respektive pas alokimit të grantit nga MASHTI.

Andaj e nderuar Ministre, ju informoj se buxheti i dërguar si shtojcë e kësaj kërkese është buxheti i dakorduar nga BE dhe Qeveria e Kosovës. Pjesa më e madhe e shpenzimeve, sikurse janë pagat janë shpenzime tanimë të ndodhura (pagat e mbuluara për periudhën Mars-Qershor), po ashtu një pjesë e madhe e shpenzimeve operative, ndërsa mbetët të shpenzohen një pjesë e mjeteve (kapitale) të parapara për disa ndërhyrje në kampusin e IBC-M në jug për të sanuar dëmet e shkaktuara nga përmbysjet që kanë ndodhur këtë vit. Përveç kësaj, dua të insistoj që pjesa korrik-tetor, përderisa jemi duke kaluar këtë fazë tranzitore, të mbulohet gjithashtu përmes një granti nga MASHT-i, i cili do të menaxhohet nga IBC-M. Rrjedhimisht, IBC-M është shumë i interesuar për çdo mundësi të asistimit apo trajnimit në lidhje me rregullat e reja të financimit në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë në sektorin publik. Konsiderojmë se këto dhe shumë çështje të tjera janë të nevojshme për t'u adresuar gjatë një takimi në një moment të përshtatshëm për ju. Jemi të gatshëm të sekuencojmë agjendën dhe të ndajmë kohë të caktuara për secilën pikë.

Ju falënderoj për kohën tuaj dhe pres me padurim të dëgjoj nga ju dhe të organizojmë një takim.

Me respekt,

Mihone Kerolli

Drejtore Ekzekutive IBC-M

from theory to practice